



Procesverbal i Takimit te 7-te te Grupit te aktoreve  
per  
Rajonin Nderkufitar “Prespa”

---

**2 Qershor 2014**

**Restorant “Aleksandar”  
Zaroshke, Komuna Liqenas, Republika e Shqiperise**

## **Pjesemaresit ne takim:**

Struktura e pjesemaresve ne takimin e 7 te SHG ka përfshirë rreth 35 antare te emëruar dhe të rinj te mundshme të SHG për Rajonin e Prespës. Takimi u organizua dhe u facilitua nga Stafi i Njësise se menaxhimit te Projektit.

Lista e plote e pjesemaresve dhe detaje per kontaktet e tyre mund te gjenden ne:

**ANNEX 1:** Participants list- lista na ucesnici- Lista e Anëtarëve 7th SHG MEETING Prespa 02.06.2014

**ANNEX 2:** SCAN Participants list- lista na ucesnici- Lista e Anëtarëve 7th SHG MEETING Prespa 02.06.2014

## **Programi i takimit:**

10:00 – 10:30 **Mberritja e pjesemaresve dhe takimi I miresearchjes**

10:30 – 10:40 **Fjalimi i Miresearchjes**

*Z. Boban Ilic, SWG Sekretar I Pergjithshem (TBC)  
Perfaqesues nga komuna bujtese e Liqenas Pustec*

10:40 – 11:30 **Qasje per zhvillimin ekonomik te integruar brenda ABDA**

Perfshirja e SHG ne proces  
Perditesime dhe Rezultate nga thirrjet per projekte ne Drina Tara and Drina Sava  
*Irena Dzimrevska Menaxhere Projekti ABDA*

11:30 - 12:00 **Pushim per kafe**

12:00 –13:00 **Prezantim dhe diskutim mbi veprimin e ABDA “Njerez tek Njerez”**

Pyetje dhe pergjigje per procesin e aplikimit  
Partneritete dhe komunikim midis partnerve potenciale  
*Znj. Liljana Tanevska, Koordinatore Rajonale per Rajonin Nderkufitar te Prespes*

13:00 – 14:00 **Dreka**

14:00 – 15:30 **Grupi i aktoreve**

Prezantimi i nomimeve te SHG dhe permbushja e kriterëve  
Zgjedhjet per Presidentin dhe Zv. Presidentin e SHG  
*Znj. Liljana Tanevska, Koordinatore Rajonale per Rajonin Nderkufitar te Prespes*

15:30 – 16:00 **Perfundimet e takimit**

16:00 – 16:30 **Nisja**

## **Procesverbal i takimit**

Takimi u hap me fjalen e miresearchjes dhënë nga Koordinatorja Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa" zonjusha Liljana Tanevska, e cila uroi ngrohesisht pjesemarresit (aktoret) e rinj ne kete takim dhe uroi nje bashkepunim sa me te frutshem me te gjithë aktoret ne kuader te kornizes se aktiviteteve te programit ABDA. Njekohesit Znj, Tanevska pasi i njohu te pranishmit me pikat e rendit te dites, i prezantoi ato dhe me stafin e ri te Njesise Menaxhuese te Projektit Z. Eglon Kondura.

Me pas ne emer te Komunes Liqenas, pritese te takimit por edhe si nje prej aktoreve brenda grupit SHG pershendeti Z. Ilo Malevski. Z. Malevski shprehu besimin e tij se ky projekt do te jete i frutshem dhe me impakt te jashtezakonshme per rajonin dhe njekohesisht ofroi gadishmerin e maksimale te komunes qe ai perfaqeson per bashkepunim ne kuader te projektit ABDA.

### **Sesioni 1**

#### ***Qasja per zhvillimin ekonomik te integruar ne kuader te ABDA***

#### ***Perfshirja e SHG ne process***

#### ***Perditesime dhe Rezultate nga thirrjet per projekte ne Drina Tara and Drina Sava***

Znj. Liljana Tanevska beri nje prezantim te shkurter te programit ABDA megjithese nje prezantim i detajuar i ketij programi ishte bere ne takimin e 6-te, Znj. Tanevska e gjykoi te rendesishme kete riprezantim per faktin se ne perberjen e grupit ishin afruar aktore te rinje te cilet merrnin pjese per here te pare ne takimet e SHG. Znj. Tanevska theksoi rendesine e rrjetezimit dhe bashkepunimit midis aktoreve te bashkesive rurale ne te anet e kufurit te shteteve te Maqedonise dhe Shqiperise dhe konkretisht ne rajonet e Ohrit, Korces dhe Resnjes. Ne fokus te ketij rrjetezimi dhe bashkepunimi jane aktivitetet qe lidhen me rritjen e konkurrueshmerise se rajonit nderkufitar duke forcuar lidhjet horizontale midis aktoreve te dy shtetet ne rajonet nderkufitare te Prespes. Aktivitetet e perbashketa ne sektoret me kryesore te Zhvillimit Rural si: sherbimet, prodhimet bujqesore dhe agro-turizmi duke nxjerre ne pah traditen dhe autoktonen, elemente keta qe per rajonet e Prespes perbejne bazen e konkurrueshmerise dhe te zhvillimit rural.

Me pas u be nje prezantim i situates ne rajonet Drina Tara dhe Drina Sava dhe u be e ditur se ne keto rajone jane celur thirrjet per Grante nga te cilat kane perfituar aktore te

ndryshem rurale brenda ketyre rajoneve dhe si rrjedhoje ata kane permiresuar teknologjine prodhimit, brandimin e produkteve te tyre si bujqesore ashtu edhe Turistike. Znj, Tanevska theksoi se rezultatet e arritura ne rajonet Drina Tara dhe Drina Sava duhet te sherbejne si nxitje edhe per rajonet e tjera te SWG.

Per momentin ne rajonet Drina Tara dhe Drina Sava ka nje rishikim te strategjise dhe kjo per shkak te gjendjes se jashtezakonshme ne keto rajone per shkak te permbytjeve. Aplikacionet e pranuar ne kuader te skemes se granteve jane vleresuar nga komisioni i vleresimit ne Beograd te 2014/05/26. Komiteti u strukturuar nga perfaqesues te ekipit te SWG-se dhe nga perfaqesuesit zyrtare te ministrive dhe nje delegatëve te SWG. Pas kryerjes ekipi i ABDA doli ne fushë ne terren për të kontrolluar situatën me përmytjet. Znj, Tanevska theksoi se diskutimet dhe procesi i identifikimit dhe vlersimit te ideve per projekte zhvillimi ne rajonet e Ohrit, Korces dhe Resnjes duhet te thellohet dhe intesifikohet me qellim finalizimin e fazes pregatitore te ABDA.

### **Pytje dhe Diskutime ne lidhje me sesionin e pare**

- **Vangjush Dishnica ( Qarku Korce)**

**Q1.** Ne fillim te projektit eshte bere nje akt marreveshje midis 37 Komunave ndersa sot sot shoh te pranishme vetem 2 prej tyre. A do te kemi nje komision te perhershëm?

**Q2.** A do te kete rimbursim te kostove te transportit per pjesemrresit ne keto takime?

Mendoj se duhet te kete me teper trainime te aspektit praktik si dhe shkembime eksperiencash midis aktoreve dhe rajoneve.

### **Liljana Tanevska**

**P1.** Ne cdo takim qe eshte organizuar komunat kane qene te ftuara. Ne planet e ardhshme eshte ri-kontaktimi i te gjitha njesive vendore qe kane nenshkruar marreveshjen e mirekuptimit ne kuader te projektit ABDA per RNK "Prespa". Gjithashtu sot eshte menduar qe te zgjidhet Presidenti dhe ZV/President i SHG, pra do te kemi nje strukture me solide ne te ardhmen.

Sot kemi kenaqesine qe ne takim eshte i pranishem Nen\Kryetari i Qarkut Korce.

**P2.** Per sa i perket pageses se kostove te transportit, nuk prashikohet nga projekti duke menduar qe impaktet e synuara te ketij projekti do te jene ne favour te SHG dhe ne kete logjike edhe anetaret e SHG duhet te jene kontribues. Gjithsesi eshte menduar nje diete ( pagese ditore) per te pranishmit.

Nevojat per trainime duhet te dalin vetem nga ju, gjithashtu ne te ardhmen ne do te qarkullojme nje formular ku ju mund ta plotesoni me propozimet tuaja ne lidhje me nevojat per trainime.

- **Naum Tashovski ( Komuna Resnje) Diskutim**

Terheq vemendjen per mbulim jo te mjaftueshem mediatik te aktiviteteve te SWG. Gjithashtu kerkon raportet ne lidhje me arritjet e SWG me qellim qe te kete mundesine ta paraqese prane keshillit te Komunes. Sugjeron qe te kete me teper perfaqesi te institucioneve shkencore. Mendon se zgjedhjet e kryetarit dhe te zv/kryetarit te SHG do te

lehtesojne punen. Ne komunen Resnje eshte krijuar nje LAG i cili tashme eshte i formalizuar. Mendon qe duhet te rrjetezohemi me nje focus me te qarte. Gjithashtu strukturat ekzistuese duhet te trajnohen ne lidhje me aplikimet per Grante. Target i synuar duhet te jete Bujqesia dhe Turizmi.

- **Viola Bogdani ( Dorkas AID) Diskutim**

Terheq vemendjen per nje qarkullim me te mire te informacionit me qellim qe te zgjohet edhe interesi i perfaqesuesve te Komunave te cilat nuk jane shume active ne kete process. Pershendet nismen e Njesise Menaxhuese te Projektit per ri-kontaktimin e te gjitha komunave pjesemarese. Sugjeron qe secili prej aktoreve te rinj pjesemarres ne takim te prezantoje vetveten me qellim qe aktoret brenda grupit ( SHG) te njohin me mire profilet e njer-tjetrit.

- **Roland Mecaj ( QTTB Korce) Diskutim**

Pershendet te pranishmit si dhe misionin e SWG. Ofron te gjitha gadishmerine e institucionit qe perfaqeson ne mbeshtetje te realizimit te objektivave te projektit. Thekson rendesine e QTTB si nje institucion shkencor ne lidhje me misionin dhe objektivat e ABDA. Thekson rendesine e formalizimit dhe te institucionalizimit te SHG.

- **Orieta Glozheni ( DMO ) Diskutim**

Duke e pare sektorin e turizmit sin je zinxhir vlerash mendoj qe ne kuader te ketij projekti duhet nje organizim ku te biznesi te vendoset akoma edhe me ne focus, patjeter qe edhe roli i aktoreve te tjere eshte i rendesishem dhe lehtesues. Ne ke te pikpamje te shohim mundesi konkrete per iniciativa te perbashketa.

Psh: Krijimi in je produkti te perbashket turistik. Aeroporti i Ohrit dhe trageti Oher-Pogradeci qe do te vendoset se shpejti jane mundesi shume te mira per organizmin e paketave te perbashketa Turistike. Trainime te perbashketa te turoperatoreve Maqedonas dhe Shqiptare. Nje calendar aktivitetesh rajonal i kombinuar si psh: ne Korce eshte festa e Birres dhe ditën tjetër ne Oher eshte nje feste tjetër.

- **Aleksander Jovanovski ( EDEN Tourism Cluster) Diskutim**

Shoqata jone ne partneritet me bashkin Pogradec fitoi nje project aktivitetet e te cilit do te shtriheshin ne te dyja rajonet. Ne fazen finale ky project nuk u financua nga donatori pasi Bashkia Oher ne momentin e fundit nuk gjeti mundesite financiare per te dhene pjesen e saj te kontributit ne kete project.

Terheq vemendjen qe komunat nuk duhet ta shohin zhvillimin e tyre nepermjet urbanizmit te tyre por nepermjet aktiviteve rurale ku promovohen vlerat dhe traditat e tyre me te mira.

- **Kristaq Shore ( TWO “ Natyra Nderkufitare” ) Diskutim**

Terheq vemendjen qe duhet pasur kujdes kur flasim per turizem. Gjithmone duhet mbajtur ne focus ruajtja e mjedisit pasi nje zhvillim mjedisor te qendrueshem nuk mund te kemi

zhvillim rural te qendrueshem. Duhet te thellohet me teper mendimi dhe te konkretizohen aktivite reale qe kane impact te drejtperdrejte ne zhvillimin ekonomik vecanerisht te Komunes Liqenas qe eshte edhe nje prej komuniteteve me te varfra ne rajon.

- **Ivan Cekic ( ECO PROME- VELOCLUB) Diskutim**

Jep shembullin e nje aktiviteti te perbashket sic eshte festimi i dites se Drinit. Dëshmon se ka pasur disa bashkepunime me partnere nga rajoni i Pogradecit dhe Institutin e Bujqesise Organike ne Durres. Organizata eshte e fokusuar ne promovimin e produkteve autoktone dhe ne promovimin e ushqimit organik. Shprehu gadishmerine dhe theksoi qe jane te hapur per partnered he bashkepunime.

- **Tomi Pikuli ( Agrinet) Diksutim**

Dëshmon se ka hyre ne fazen e disa aksioneve konkrete per bashkepunim me disa partnere nga Maqedonia. Ka mare nje ftese nga Komuna Resnje ne lidhje me nje aktivitet qe ka te beje me organizmin e Festes se Molles ne Resnje dhe i eshte pergjigjur pozitivisht kesaj ftese. Gjithashtu po mendon per realizimin e nje tjeter aktivitetit qe ka te beje me organizmin e nje shkembime experience midis prodhuesve te molles ne rajonin e Korces dhe Resnjes.

**Liljana Tanevska.** Do te kihet parasysh per nje mbulim me te mire mediatik. Per sa i perket insitucioneve shkencore sot kemi nderin qe per here te pare kemi perfaqesuesin e QTTB Korce dhe ne takimet e ardhshme do te ftohen edhe Universitetet.

Jemi gjithmone te hapur per perfshirjen e aktoreve te rinj.

Projekti ABDA eshte nen shqyrtim nga Komisioni European dhe mund tju them se ka eccuri pozitive.

Ne jemi ne nje faze qe po mbledhim material promocional nga rajonet perkatese ne te dyja shtetet. Theksoi qe nga pala Maqedonase eshte mbledhur shume informacion ne lidhje me kete aktivitet dhe po punohet edhe me palen Shqiptare.

Per sa i perket project propozimeve konkrete ato duhet te dalin vetem dhe vetem nga ju. Programi “Njerez tek Njerez” eshte nje mundesi e mire per te konkretizuar idete tuaja.

Persa iu perket trainimeve dhe ngritjes se kapaciteteve nevojat dhe propozimet duhet te dalin nga ju dhe ne si Njesi Menaxhuese e Projektit do te vleresoyme dhe shqyrtojme me kujdes secilen prej tyre.

Do te shohim mundesine nqs mund te mbeshtesim procesin e perfshirjes se Liqeneve te Ohrit dhe Prespes ne fondin e UNESKO.

## Sesioni 2

*Diskutime dhe prezantim i kriterëve për mbështetjen e mundshme në aktivitetet "Qytetaret për qytetaret" në rajonin "Prespa"*

*Pyetje përgjigje për procesin e Aplikimit  
Partneritete dhe komunikim midis Aktoreve*

Në fillim të këtij të keqti sesioni secili prej pjesëmarrësve bëri një prezantim të organizatës që përfaqëson si dhe të fushës së interesit për përfshirje në aktivitete brenda programit ABDA.

Në këtë sesion nga Znj. Tanevska u bë një prezantim i programit "Njerez tek Njerez" si dhe një prezantim i formatit të Aplikimit për thirrje për projekt-propozimet "Njerez tek Njerez". Znj. Tanevska ftoi pjesëmarrësit që të jenë vëmendshëm dhe të përfitojnë nga ky takim për të identifikuar partnerë potencialë.

Gjithashtu u prezantua dhe Aneksët në lidhje me aplikimin si:

Anex 1: Format i buxhetit

Anex2: Kriteret e vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekt –propozimeve.

### Me pashte gjeime një përmbledhje të séances së pyetje-përgjigjeve në lidhje me programin "Njerez tek Njerez"

Q1. Cili është kufiri minimal dhe maksimal i buxhetit të aplikuar në një projekt propozim?

P1. Nuk kemi një përgjigje për buxhetin por ajo që ju këshilloj duke marrë shkas edhe nga projekt-propozimet në rajonet Drina Tara dhe Drina Sava është që shumata e projekteve të tyre kanë qenë të vogla në nivelin 2000 – 3000 Euro.

Q2. Kur është deadline për dorëzimin e aplikimeve?

P2. Nuk ka deadline për dorëzimin e aplikimeve por mund t'ju them që në fazën vlerësuese do të ketë avantazh për aplikimet që janë dorëzuar më parë.

Q3. Duke pasur parasysh që buxheti është i vogël...a është e mundur që ky buxhet të shërbejë si një pjesë komplementare e një aktiviteti tjetër?

P3. Po mund të aplikohet dikë e tilla

Q4. A mund të aplikohet në më tepër se një projekt?

P4. Po mund të aplikohet në më tepër se një projekt por gjithmone duhet tju referoheni **kriterëve** dhe të siguroheni që të mos ketë mbivendosje.

Q5. A mund te aplikohet per Trainime teknike per fermeret nga ted y anet e rajonit apo dhe per publikime te ndryshme teknike?  
P5. Nqs keto publikime jane pjese e aktivitetit ateherë Po.

### **Sesioni 3**

#### ***Prezantimi i nomimeve te SHG dhe permbushja e kriterëve Zgjedhjet per Presidentin dhe Zv. Presidentin e SHG***

Gjate ketij sesioni u prezantua nje informacion ne lidhje me prezencen e secilit prej aktoreve te SHG ne secilin prej 7 takimeve te organizuara.

Me pas u kalua ne séancen e perzgjedhjes se strukutres drejtuese te SHG ( president dhe zv/president). Mbas diskutimeve te shumta ne lidhje me procesin e votimit si dhe me kriteret qe duhet te permbushnin personat qe do te perzgjidheshin per keto funksione u propozua per President te SHG, **Znj. Viola Bogdani** ( Dorkas AID) dhe per Zv/President **Z. Naum Tashovski** ( Komuna Resnje)

**Propozimet u hodhen ne votim te hapur dhe me shumice te dyja kandidaturat u votuan!**

### **Sesioni 4**

#### ***Konkluzione dhe mbyllja e takimit***

- Konkluzionet nga takimi janë përmbledhur nga KR e ABDA per RNK “Prespa” Znjsh. Liljana Tanevska :
- Zyra e projektit do të informojë SHG ne lidhje me disponueshmërinë e aplikimit për mbështetjen ABDA “Njerez tek Njerez”
- Zyra e projektit të shërbejë si pikë për mbështetjen e SHG
- SHG do të përfshijë më shumë antare nga sektori privat
- SWG do të informojë SHG për progresin e miratimit te ABDA në KE
- Me teper mbulim mediatik do te kete per aktivitetet e ardhshme te SWG ne kuader te ABDA program.
- Te gjithë aktoret e SHG do te lajmerohen ne lidhje me takimin e 8-te te SHG

#### **Pregatiti:**

Eglon Kondura  
Asistent Teknik CBR Prespa